



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ



P.nr.575/18

Numri i lëndës: 2018:013136
Datë: 29.08.2018
Numri i dokumentit: 00114302

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, me gjyqtarin individual Adem Shabani dhe me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED], me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Shtime, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.2 nën par 2.5 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/nr.732-3/18 të datës 24.04.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor fillestare me dt.29.08.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit shtetit Abdullah Abedini, të dëmtuarit [REDACTED] dhe të pandehurit, të nejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Shtime, i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] e ēma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shtetas i Republikës së Kosovës, shqiptar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar i pa punë, me nr.personal [REDACTED] mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 06.10.2017, në kohë të panjohur, në parkingun e quajtur “Mustaf Goga” në rrugën “Tahir Sinani”, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, nga automjeti “Seat Altea”, ngjyrë e kaltërt ka marrë një revole të tipit “ZIG PX0”, prodhim turk, kalibri 9 mm, me numër serik [REDACTED], prone e të dëmtuarit [REDACTED]

-me këtë ka kryer veprën penale penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.2 nën par 2.5 të KPRK-së.

Gjykata në bazë dhe neneve 4, 7, 17, 23, 41, 42, 43, 45, 73, 74, 75, 76 par.1 nën par 1.3 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-së, e:

G J Y K O N

Të akuzuarit [REDACTED] i shqipton dënim burgimi në kohëzgjatje prej një /1/ viti të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjyki të merr formën e prerë, nën kërcënim te ekzekutimit me dhunë.

Idëmtuari [REDACTED] me vendbanim në Ferizaj, rruga [REDACTED], katër [REDACTED] për realizimin e kërkesë pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfujqishmërisë së këtij aktgjykiem, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/nr.732-3/18 të datës 24.04.2018, e ka ngarkuar të pandehurin [REDACTED] me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Shtime, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.2 nën par 2.5 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rrëth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt. 29.08.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurorja e shtetit Avdullah Abedini, dhe i pandehuri [REDACTED].

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën të akuzuarit, ku gjyqtari gjykues është bindur se i akuzuari pas leximit të aktakuzës e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtë i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDACTED] në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale që akuzohet dhe në vazhdim ka theksuar se ditën për të cilën akuzohet ka shkuar në Ferizaj, dhe pasq i është shëtitur në qytet ka hyrë në një kafiteri ku ka qëndruar një kohë , dhe kur ka dalë nga aty në parking është ofruar afér një vture dhe e ka provuar derën e saj se a është e hapur dhe ajo ishte e pa mbyllur me qelës, e ka hapur derën dhe ka hyrë brenda ku aty hapur fiokën përparrë në veturë ku aty ka vërejtur një revole e cila ishte e zbrazur dhe të hequr edhe karikatorin nga revolja ku në karikator kishte tetë plumba, dhe e ka marrë revolen nga aty dhe ka dalë jashtë veturës dhe e ka vendosur në brez dhe është nisur për në qytet dhe ka

shkuar tek "Hib Petrol" afër stacionit të policisë në Ferizaj ku aty ishte një person duke pirë kafe i ka thënë se punëtorët që punojnë aty i kanë thënë se e ke një revole në brez a e shet atë dhe i kam thënë po për 600 Euro por i ka thënë a ma jep për 300 Euro dhe i ka dhënë dhe ai është larguar nga atu dhe ky ka shkuar në shtëpi dhe këto para i k a harxhuar por më vonë është njoftuar se revolen që e ka vjedhur në veturë është e personin i cili është këtu në gjykim [REDAKTUE] pasi e njehë e me qëllim që të bie në kontakt me personin që e ka blerë revolen ka shkuar dy tri herë që ta takon edhe pse nuk e njehë por nuk e ka takuar i kërkoj falje të dëmtuarit [REDAKTUE]

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori shtetit Avdullah Abedini, ka dekluar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi pranimi i tillë është bërë konform ligjit gjegjësish në bazë të nenit 248 të KPPRK-së, dhe ka mbështetje edhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës e të cilat e vërtetojnë gjendjen faktike.

I dëmtuari [REDAKTUE] në shqyrtimin fillestar në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pajtohet dhe i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe mbetët pranë kërkësës pasurore-juridike por pasi nuk e ka precizuar shumën, këtë do ta inicon në procedurë civile. Lidhur me këtë rast ka ra në kontakt me familjen e të pandehurit me që njihen edhe më herët, por deri me këtë rast me to nuk ka pasur asnjëherë problem, por i pandehuri [REDAKTUE] i bënë këto veprime pasi edhe me gjendje shëndetësore-mendore nuk është në gjendje të mirë.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në Kallëzimin penal nr.2018-AU-3'15, në dëshminë e të dëmtuarit dhënë në polici me datën 10.10.2017 dhe prokurori me datën 24.04.2018 dëshminë e të pandehurit dhënë në polici me datën 24.01.2018, dhe në shkresat tjera që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazduar me shqiptimin e dënimit (nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.2 nën par 2.5 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit, pendimin për veprën penale të kryer, i ka kërkuar falje të dëmtuarit në seancën gjyqësore gjendje jo të mirë shëndetësore, i gjendjes jo të mirë ekonomike i pa punë, gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmérinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, të akuzuarit në mbështetje të dispozitave të neneve 75,76 të KPRK-së i shqipton denim burgimi në kohëzgjatje prej një /1/ viti të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjyki merr formën e prerë, nën kërcënim te ekzekutimit me dhunë, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerës si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimi mor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konform nenit 463 par.2. të KPPK-së, i dëmtuarit [REDACTED], me vendbanim në Ferizaj, rruga [REDACTED], katër [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.575/18 me datë 29.08.2018

Zyrtare Ligjore

Kadishe Shabani

Gjyqtari

Adem Shabani



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykatë.